

## Syllabusi i lëndës: Psikologji ndërkulturore

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti Filozofik – Departamenti i Psikologjisë</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Psikologji ndërkulturore</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Master</b>
<b>Statusilëndës:</b>	<b>Zgjedhore</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>I</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>2+1</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>5</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>Për t’u definuar</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Dr. Ram Thein</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	
	<p>Kjo lëndë ofron një zbërthim të çështjeve studimore të psikologjisë ndërkulturore përsa u përket çështjeve të personalitetit, psikologjisë sociale dhe psikologjisë së komunitetit. Gjithashtu, kursi trajton ndërveprimin e faktorëve individual, etnikë dhe kulturorë në rritjen psikosociale dhe mirëqenien, duke theksuar gjithashtu komunikimin ndërkulturor. Në fund, lënda do të diskutojë edhe ndërveprimet këshillimore dhe psikoterapeutike nga pikëvështrimi ndërkulturor.</p> <p>Kursi fokusohet në të dy perspektivat, ndryshueshmëritë brenda kulturës si dhe ndërmjet kulturave, duke integruar poashtu aspektet bazë të hulumtimeve ndërkulturore dhe studimit të sjelljes në kontekstet ndërkulturore.</p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<p>Kursi ka për qëllim që të eksplorojë dallimet kulturore duke përdorur perspektivën psikologjike. Kursi poashtu synon që të familiarizojë studentët me njohuri kulturore lidhur me kompleksitetin dhe ndërvarësinë e ngjarjeve globale dhe çështjeve të tjera, duke përfshirë të kuptuarit mbi diversitetin e vlerave, besimeve, ideve; poashtu synim tjetër është familiarizimi i studentëve me rrespektimin e diversitetit global dhe qëndrimeve ndërkulturore, përfshirë këtu edhe kuriozitetin dhe të qenurit të hapur ndaj mundësive të reja, ideve dhe mënyrave të të menduarit; vetëdijësim mbi dallimet etnike dhe kulturore; aftësinë për të ekzaminuar çështjet në mënyrë objektive dhe pa paragjykime; vetëdijësim mbi kulturën dhe identitetin. Në kuadër të këtij familiarizimi, qëllim tjetër është që përmes këtij kursi të arrihet të menduar kritik dhe kreativitet në integrimin e dijes mbi botën; të komunikuarit në mënyrë efektive dhe të ndërvepruarit me njerëzit nga kulturat e ndryshme. Në përgjithësi, përmes këtij kursi synohet që të ngritet vetëdija e studentëve lidhur me balancin ndërmjet faktorëve socialë dhe biologjikë të sjelljes njerëzore.</p>

<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p>Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ tregojnë të kuptuar mbi definicionet, terminologjinë kyçe dhe çështjet komplekse të psikologjisë ndërkulturore; të njohin dhe përshkruajnë se si teoritë e psikologjisë ndërkulturore shpjegojnë ndikimin e kushteve njerëzore në përgjithësi dhe niveleve të veçanta kulturore që tregojnë ndjeshmëri ndaj problemeve të konflikteve ndërkulturore; do të duhej të dijnë për gjetjet bazë të studimeve ndërkulturore si dhe të jenë në gjendje të ndërmarrin një studim valid të sjelljes në kontekste ndërkulturore; të identifikojnë rolin e racës, etnicitetit, trashëgimisë kulturore, nacionalitetit, statusit socio-ekonomik, strukturës familjare, moshës, gjinisë, orientimit seksual, religjionit dhe besimeve shpirtërore, profesionit, statusin fizik dhe mendor dhe çështjeve të tjera lidhur me drejtësinë shoqërore në mirëqenien e përgjithshme të individit.</li> </ul>
-----------------------------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet			1
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	2	5	10
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgaditja përfundimtare për provim			6
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)			1
Projektet,prezentimet ,etj			2
<b>Totali</b>			<b>125</b>

<b>Metodologjia e mësimëdhënies:</b>	Kursi do të realizohet përmes ligjeratave të rregullta, interactive, me metoda më të avancuara, ushtrimeve praktike, diskutimeve në grup, involvimin në prezantime dhe raste të studimit, punime të tjera të temave relevante me kursin, punë ekipore për analizimin dhe zhvillimin e mini hulumtimeve lidhur me temat e studimit, konsultime gjatë gjithë semestrit, etj.
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Vijimi dhe konsultimet e rregullta: 10% Angazhimi në punë ekipore: 30% Provimi final: 60%
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	Berry, J., Poortinga, Y., Breugelmans, S., Chasiotis, A. & Sam, D. (2011). <i>Cross Cultural Psychology Research and Applications</i> , Cambridge University Press. ISBN: 978 0 521 76212 – 0  Shiraev, E. & Levy, D. (2010) <i>Cross Cultural Psychology: Critical Thinking and Contemporary Applications</i> , Fourth Edition. New York: Allyn & Bacon.
<b>Literatura shtesë:</b>	Van de Vijver, F.J.R. & Leung, K. (2000). Methodological issues in psychological research on culture. <i>Journal of Cross-Cultural Psychology</i> , 31, 33-51  - Elfenbein, H. A. & Ambady, N. (2002). On the universality and cultural specificity of emotion recognition: A meta-analysis. <i>Psychological Bulletin</i> , 128(2), 203-235  - Trimble, J. E. & Dickson, R. (2005). Ethnic identity. In C. B. Fisher & Lerner, R. M. (Eds.), <i>Encyclopedia of applied developmental science</i> , (pp. 415-420) (Volume I). Thousand Oaks: Sage.

<b>Plani i detajuar i edukimit për një semestër</b>	
<b>Java</b>	<b>Tema</b>
<b>Java 1;</b>	Hyrje – Çfarë është Psikologjia Ndërkulturore
<b>Java 2;</b>	Dallimet dhe Ngjashmëritë në sjellje përgjatë kulturave
<b>Java 3;</b>	Zhvillimi i Individit: fëmijëria, adoleshënca dhe moshë e rritur
<b>Java 4;</b>	Sjellja Sociale

<b>Java 5;</b>	Personaliteti
<b>Java 6;</b>	Kognicioni
<b>Java 7;</b>	Emocioni
<b>Java 8;</b>	Gjuha
<b>Java 9;</b>	Perceptimi
<b>Java 10;</b>	Relacioni ndërmjet sjelljes, kulturës, biologjisë
<b>Java 11;</b>	Kontributi i biologjisë evolucioniste
<b>Java 12;</b>	Metodologjia dhe Teoria / Të aplikuarit e gjetjeve të hulumtimeve përgjatë kulturave të ndryshme
<b>Java 13;</b>	Marrëdhëniet ndërkulturore
<b>Java 14;</b>	Komunikimi ndërkulturor dhe trajnimi
<b>Java 15;</b>	Puna dhe Organizata; Shendet
<b>Definimi i përbashkët i rregullave me studentët:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mësimdhënësi do të ndihmojë të nxënit e studentëve dhe arritjet e qëllimeve të lëndës përmes vlerësimit të progresit të studentëve në vazhdimësi dhe në një mënyrë që ju ofron atyre prapaveprim (feedback) të përdorshëm;</li> <li>- Studentët janë fuqimisht të inkurajuar që të bëjnë pyetje, të komentojnë dhe të marrin pjesë në diskutimet klasore;</li> <li>- Sjellja e duhur akademike është e domosdoshme. Kopjimi i punës së të tjerëve, përdorimi i materialeve të pa-aprovuara gjatë provimeve dhe kuizeve, apo marrja (duplikimi) e/i punës së tjetrit paraqet mashtrim dhe nuk do të tolerohet;</li> <li>- Përdorimi i lap-topëve (kompjuterëve) lejohet vetëm me aprovimin paraprak të mësimdhënësit;</li> <li>- Përdorimi i telefonave mobil nuk është i lejuar;</li> </ul>	